



Global Education First Initiative

The UN Secretary-General's Global Initiative on Education

Vizatojmë aftësinë e kufizuar Udhëzues për mësues



OBSERVATORY
FOR INCLUSION

YAG Youth
Advocacy
Group

Technical partners



Ky udhëzues është hartuar për mësuesit dhe shkollat në të gjithë botën të cilët kanë interes të bashkohen me fushatën **#DrawDisability** (vizato aftësinë e kufizuar) për të çuar përpara advokasinë për këtë çështje përpara.

Detaje rreth fushatës mund të merren në: at www.globi-observatory.org/DrawDisability.

Udhëzuesi ndahet në dy pjesë.

Pjesa e parë: tregon përkufizime dhe çështje të tjera të rëndësishme për aftësinë e kufizuar.

Pjesa e dytë prezanton një grup aktivitietesh të cilat mësuesit mund ti përdorin në klasë. Këto janë aktivitete të sugjeruara dhe mësuesit janë të lirë të krijojnë, iniciojnë sipas kushteve në të cilat punojnë dhe mësojnë nxënësit e tyre me aftësi të kufizuar. Mësuesit inkurajohen t'i bëjnë kë ushtrime gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit duke përfshirë ata me aftësi të kufizuar.

Aktiviteti final fton të gjithë nxënësit të ndajnë të kuptuarit e tyre për aftësinë e kufizuar duke e vizatuar sesi e shohin ata Personin me Aftësi të Kufizuar në komunitetin e tyre. Perspektivat e fëmijëve mund të nënvizojnë përpjekjet sfidat si dhe arritjet dhe sukseset që Personat me Aftësi të Kufizuar hasin dhe arrijnë në komunitetin ku jetojnë. Vizatimi do të tregojë të kuptuarit dhe ndjenjat e tyre për aftësinë e kufizuar., ndryshueshmërinë, aksesin, gjithëpërfshirjen dhe diskriminimin.

Tabela e lëndës

PJESA 1 • TË KUPTUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Ç'është aftësia e kufizuar? 1

Cilët quhen njerëzi me aftësi të kufizuar? 2

Gjithëpërfshirja shoqërore e njerëzve me aftësi të kufizuar 2

Fëmijët me aftësi të kufizuar kanë të drejtë për arsimim 3

PJESA 2 • KRIJIMI I NJË PROJEKTI ARTISTIK GLOBAL 4

Veprimtaria 1: Të kuptojmë paaftësinë e kufizuar! 4

Veprimtaria 2: Të vizatojmë Aftësinë e Kufizuar! 5

Informacione të tjera 6

ANEKSI 1: FOTO 7

ANEKSI 2: VEPRIMTARI SIMULUESE TË SUGJERUARA 21

KOMUNIKIMI NË AFTËSINË E KUFIZUAR 21

DËMTIMI I DËGJIMIT 21

TË MËSUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR 22

AFTËSITË E KUFIZUARA INTELEKTUALE 22

DËMTIMET E SHIKIMIT 23

AFTËSITË E KUFIZUARA FIZIKE 23

PJESA 1

TË KUPTUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Ç'ËSHTË AFTËSIA E KUFIZUAR?

Aftësia e kufizuar është një koncept kompleks: faktorë të shumtë kulturorë, historikë, ligjorë, shoqërorë dhe filozofikë ndikojnë mbi interpretimin e saj. Kuptimi i saj ndryshon sipas kontekstit, në të cilën ajo trajtohet; për shembull, punonjësit dhe organizatat e ndryshme që trajtojnë aftësinë e kufizuar, mund të kenë përkufizime të ndryshme mbi aftësinë e kufizuar.

Preambula e Konventës për të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara (KDNJAK) thekson se:

Aftësia e kufizuar është një koncept lëvizës dhe [...] rezultat i bashkëveprimit midis individëve me dëmtime dhe pengesa komportamentale dhe mjedisore, të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre efektive në shoqëri, mbi baza të barabarta me të tjerët.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) jep përkufizimin e mëposhtëm:

Aftësia e kufizuar është një term ombrellë, i cili mbulon dëmtimet, kufizimet e veprimtarisë dhe kufizimet e pjesëmarrjes. Një dëmtim përbën problem në funksionin ose strukturën trupore; kufizimi i veprimtarisë përbën vështirësinë me të cilën ndeshet një individ i caktuar në kryerjen e një detyre ose veprimi; ndërsa një kufizim i pjesëmarrjes është problemi i përjetuar nga një individ, lidhur me angazhimin e tij në situatat e jetës.

Kësisoj, aftësia e kufizuar nuk është thjesht një problem shëndetësor. Ajo përbën një dukuri komplekse, që pasqyron ndërveprimin midis tipareve të trupit të një individi me tiparet e shoqërisë, ku ai ose ajo jeton. Tejkalimi i këtyre vështirësive nga ana e njerëzve me aftësi të kufizuara, kërkon heqjen e pengesave mjedisore dhe shoqërore.

TË KUPTUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Cilët janë njerëzit me aftësi të kufizuara?

Neni 1 i KDNJAK thekson se:

Në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara përfshihen ata njerëz që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose sensoriale, të cilat në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri mbi një bazë të barabartë me të tjerët.

Gjithashtu, në vlerësimin e OKB-së nënvizohet se:

Një person me aftësi të kufizuara mund të konsiderohet si një individ me aftësi të kufizuara, në një shoqëri apo mjedis të caktuar dhe jo në një tjetër, në varësi të rolit që ky individ hamendësohet të marrë në këtë apo atë komunitet ku jeton. Perceptimi dhe realiteti i aftësisë së kufizuar varen gjithashtu nga teknologjitë, ndihma dhe shërbimet e disponueshme, si edhe nga konsiderata të natyrës kulturore.

UNESCO vlerëson se:

Në gjithë botën, më shumë se një miliard njerëz, pothuajse 15% e popullsisë botërore, jetojnë me ndonjë formë aftësie të kufizuar fizike ose mendore. Mungon një e dhënë konkrete lidhur me shkallën e vërtetë të përhapjes së aftësive të kufizuara në krejt botën. Sipas një vlerësimi, 93 milionë fëmijë nën moshën 14 vjeçare, jetojnë me një aftësi të kufizuar të lehtë ose të rëndë. (*EFA Global Monitoring Report 2013/2014*)

Përfshirja shoqërore e Personave me Aftësi të Kufizuara

Në pjesën më të madhe të vendeve të botës ekzistojnë stereotipe dhe paragjykime lidhur me njerëzit që kanë gjendje apo ndryshime të caktuara. Këto qëndrime i japin trajtë asaj se kush duhet të konsiderohet një person me aftësi të kufizuar; gjithashtu ato kontribuojnë në krijimin e një imazhi negativ për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me krijimin e stereotipeve negative, një rol të rëndësishëm ka luajtur gjuha e përdorur. Terma të tillë si “sakat”, “mendërisht i vonuar”, “ulok”, ose “njerëz të paaftë” janë veçanërisht të pavend, pasi ato nxjerrin në plan të parë paaftësinë dhe pastaj individin.

TË KUPTUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAAR

Lëvizja për mbrojtjen e njerëzve me aftësi të kufizuara, ve në dukje se ajo ç'ka e bën një individ të paaftë është shoqëria dhe jo dëmtimi i tij ose i saj. Për shembull:

- Një individ në një karrocë me rrota mund të ketë vështirësi në punësimin e tij, jo për shkak të gjendjes së tij ose të saj, por sepse në vendin e punës ekzistojnë pengesa, që nuk e lejojnë atë të ketë akses në të.
- Një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale mund të ketë vështirësi për të shkuar në shkollë, për shkak të qëndrimit të mësuesve, të trupës mësimore dhe të prindërve, të cilët nuk janë në gjendje t'u përshtaten mësimdhënies ndaj nxënësve me aftësi të ndryshme nxënieje.
- Në një shoqëri, ku lentet korrektuese janë të disponueshme për dikë që vuan nga miopia ekstreme (dritëshkurtësia), ky person nuk duhet të konsiderohet me aftësi të kufizuar. Megjithatë, dikush në të njëjtën gjendje, në një shoqëri ku lentet korrigjuese nuk kanë qenë të disponueshme, do të konsiderohej si një individ me aftësi të kufizuar, veçanërisht nëse niveli i shikimit e pengonte këtë individ në kryerjen e disa detyrave, siç kanë qenë, për shembull, ato të ruajtjes së bagëtive, të qepjes ose të marrjes me bujqësi.

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për Shkollim

Shkollimi është një e drejtë themelore njerëzore, thelbësore për arritjen e të gjithë të drejtave njerëzore. Në këtë kuadër, ai duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë njerëzit pa dallim. Megjithatë, akoma sot, më shumë se 58 milionë fëmijë nuk kanë akses në arsimim. Grupet vulnerabël dhe ato të marginalizuara, shpesh përjashtohen nga e drejta për arsimim të barabartë dhe cilësor.

PJESA 2


KRIJIMI I NJË PROJEKTI ARTISTIK GLOBAL

Veprimtaria 1: Të kuptojmë aftësinë e kufizuar

1. Mësuesi tregon në klasë foto me fëmijë me aftësi të kufizuara (shih Aneksin 1). Ai ose ajo bën pyetjet e mëposhtme, për të nisur një diskutim:
 - a. Çfarë shihni në këto foto?
 - b. Çfarë mendoni se po bëjnë këta fëmijë në foto?
 - c. Pse ai ose ajo po përdorin një karrocë me rrota, një bastun, etj?

Mësuesi vazhdon të bëjë pyetje të rëndësishme, me synimin për të nxitur debatin, deri sa në diskutim të hyjë tema e aftësisë së kufizuar.

2. Përmes përdorimit të figurave, mësuesi u kërkon nxënësve të ndajnë së bashku përcaktimin ose mendimet e tyre lidhur me aftësinë e kufizuar. Ai ose ajo i nxit nxënësit të reflektojnë lidhur me konceptin e diversitetit, të parë më tepër si një vlerë, sesa si një pengesë. Mësuesi përmbledh përgjigjet e dhëna nga klasa, duke nxjerrë në pah një përkufizim të thjeshtë lidhur me aftësinë e kufizuar.
3. Mësuesi prezanton një veprimtari, e cila synon t'i japë mundësi nxënësve të klasës, të përjetojnë aftësi të kufizuara të natyrave të ndryshme, që nxënësit shohin në komunitetin e tyre. Kjo veprimtari ka një karakter simulues dhe realizohet në grupe (shih Aneksin 2). Qëllimi i saj është t'u japë mundësi nxënësve të eksplorojnë aftësitë e kufizuara të natyrave të ndryshme dhe të kuptojnë se **aftësitë e kufizuara janë njëherazi 'të dukshme' dhe 'të padukshme'**. Pas simulimit, mësuesi shpenzon 15 minuta për debat me nxënësit, gjatë të cilave pasqyrohet qëllimi i veprimtarisë. Mësuesi duhet të presë prej fëmijëve përgjigje si: 'Na pëlqeu ajo që bëmë'. Pastaj, ai ose ajo i fton nxënësit të reflektojnë lidhur me impaktin afatgjatë që disa dëmtime mund të kenë mbi jetën e tyre.




4. Në klasë ngrihet një pyetje: **si mund të krijojmë ne një mjedis gjithëpërfshirës dhe dashamirës, në mënyrë që të gjithë fëmijët, me ose pa aftësi të kufizuara, të kenë mundësi për shkollim?** Mësuesi mbledh përgjigjet nga klasa. Pastaj, ai ose ajo, paraqet disa prej pikave të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen shoqërore të personave me aftësi të kufizuara (Shih Pjesën 1: «Të kuptuarit e Aftësisë së Kufizuar»).



KRIJIMI I NJË PROJEKTI ARTISTIK GLOBAL

Veprimtaria 2: Të vizatojmë aftësinë e kufizuar! (1-2 orë)

1. Mësuesi prezanton nismën e **#Vizatimit të Aftësisë së Kufizuar**. Ai ose ajo u shpjegon nxënësve se ata janë pjesë e një projekti artistik global, bashkë me shumë fëmijë të tjerë nëpër botë. Mësuesi i motivon nxënësit të marrin pjesë në të, duke u thënë atyre se vizatimet e tyre mund të ndryshojnë jetën dhe fëmijërinë e shumë fëmijëve me aftësi të kufizuara në mbarë botën. Nxënësit duhet ta dinë se përse kjo fushatë është e rëndësishme dhe në ç'mënyrë ata do të ndikojnë mbi ndryshimin e stereotipeve dhe qëndrimeve. Arti paraqitet si një mjet rrëfimi për ndryshim shoqëror.
 2. Nxënësit nxiten të **#Vizatojnë Aftësinë e Kufizuar**. Në vizatimet e tyre ata do të japin se si e kuptojnë dhe e përjetojnë ata aftësinë e kufizuar si edhe çështjet që lidhen me të, të tilla si të qenurit ndryshe, aksesibilitetin, përfshirjen dhe diskriminimin. Këndvështrimet e fëmijëve dhe të rinjve mund të nxjerrin në pah betejat, sfidat si edhe realizimet e sukseset që njerëzit me aftësi të kufizuara (PAK) kanë hasur dhe realizuar në komunitetet e tyre. Veçanërisht, mësuesi duhet të përpiqet të krijojë te nxënësit një vetëdije të veçantë lidhur me “aftësitë e kufizuara të padukshme”, dhe t'i ndihmojë ata në gjetjen e rrugëve krijuese për portretizimin e krejt spektrit të aftësive të kufizuara, dëmtimeve dhe gjendjeve të ndryshme (p.sh. dëmtime të dëgjimit, aftësi të kufizuara intelektuale, etj.).
 3. Nxënësit ftohen të përdorin një letër format A4 (ose me përmasat 8.5' X 11”), dhe përdorimin e ngjyrave.
- 

Informacion i mëtejshëm



- **Convention on the Rights of Persons with Disabilities:**
<http://www.un.org/disabilities/default.asp?navid=12&pid=150>
- **UN Enable – What is Disability:**
<http://www.un.org/esa/socdev/enable/convinfofaq.htm>
- **UNESCO – 2014 Education for All Global Action Week**
“Equal Right, Equal Opportunity: Education and Disability”:
<http://www.unesco.org/new/en/education/themes/leading-the-international-agenda/education-for-all/advocacy/global-action-week>
- **WHO – Disabilities:**
<http://www.who.int/topics/disabilities/en/>

Aneksi 1: foto



Fëmijë të shkollës Ntinda, për Shurdhët, Kampala, Uganda. Shkolla është hapur më 1974 dhe ka klasa që shkojnë nga viti i parë i fillores deri në klasën e shtatë. Të gjithë nxënësit janë shurdhë dhe 20 fëmijë janë të shurdhër dhe të verbër.

Aneksi 1 : vazhdim



Një nxënës 17 vjeçar që vuan nga një aftësi e kufizuar intelektuale, gjatë përdorimit të kompjuterit pranë Qendrës Assanad, destinuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, në Tuniz. Një punonjës social po e ndihmon. Assanad, që do të thotë 'mbështetje' në arabisht, administrohet nga Institucioni i Ministrisë për Çështjet Sociale. UNICEF mbështet trajnimin e stafit të Qendrës dhe të punonjësve socialë.

Aneksi 1: vazhdim



Qendër për nxënësit me aftësi të kufizuara në fshatin El Alia, në krahinë e Bizertës veriore. Qendra administrohet nga Shoqata për Mbrojtjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, me mbështetjen e UNICEF-it.

Aneksi 1: vazhdim



Një fëmijë autik praktikon ngjyrosjen në klasë, pranë Fondacionit për Mirëqenien e Fëmijëve Autikë, në Daka.

Aneksi 1: vazhdim



Fëmijë gjatë pjesëmarrjes së tyre në një orë mësimi profesional, duke bërë byzlykë me rruaza pranë Qendrës që mbështet Zhvillimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, të vendosur në shkollën me konvikt Nguyen Dinh Chieu në Da Nang, Vietnam. Dy prej tyre kanë aftësi të kufizuara në pikëpamje të mësimit dhe tjetri është pjesërisht i verbër.

Aneksi 1: vazhdim



Nxënës duke kërcyer në një shkollë në Tikatoli, Daka. Një prej fëmijëve nuk mund të flasë. Veprimtaria i ndihmon të gjithë nxënësit të komunikojnë përmes lëvizjeve të trupit.

Aneksi 1: vazhdim



Një burrë me vajzën e tij, e cila vuan nga aftësi të kufizuara fizike, në shtëpinë e tij në fshatin Kantaramba, të krahinës Kaputa të provincës veriore të Zambias. Kjo vajzë nuk mund të vetushqehet, nuk ecën dhe nuk kryen asnjë prej veprimeve të përditshme, që e motra e saj binjake mund të bëjë.

Aneksi 1: vazhdim



Dy fëmijë ulur së bashku buzë një pishine në një Qendër për fëmijë me aftësi të kufizuara, nën administrimin e OJQ-së CIREC (Qendra kolumbiane për rehabilitimin integral), në periferi të kryeqytetit Bogota. Vajza në foto, ka humbur një këmbë si rrjedhojë e shpërthimit të një granate, të sjellë në shtëpi nga një kushëri i saj pa e ditur rrezikun që ajo paraqiste. Djali në foto ishte larguar nga shtëpia e tij në moshën 11 vjeçare dhe është shpëtuar nga rruga. Ai thotë se ka lindur pa një këmbë, por punonjësit socialë dyshojnë se ai e ka humbur atë si pasojë e një plagosjeje që ka lidhje me luftën.

Aneksi 1: vazhdim



Pas grumbullimit të mëngjesit, fëmijët, përfshi këtu edhe një djalë me paterica, nisin të hyjnë në klasat e tyre në shkollën fillore publike Khamdan Khadek në fshatin Al Hol të krahinë verilindore Hsakeh. Fëmijët irakianë të Palestinës, që jetojnë pranë një kampi refugjatësh, shkojnë në shkollë bashkë me fëmijë sirianë.

Aneksi 1: vazhdim



Nxënës, duke luajtur në Qendrën për Rehabilitimin e Paralitikeve (QRP), një shkollë për fëmijë me aftësi të kufizuara, në Bangladesh.

Aneksi 1: vazhdim



Dy nxënës ngrenë lart vizatimet e tyre në kopshtin e tyre, në Novi Sad, kryeqytet i provincës së Vojvodinës. Një prej tyre ka lindur me probleme dëgjimi dhe është i vetmi nxënës me nevoja të veçanta në klasë. Ky kopsht është një prej të parëve, që pranon fëmijë me aftësi të kufizuara, si pjesë e një ligji që parashikon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të rregullta.

Aneksi 1: vazhdim



Çaste pas vaksinimit kundër shytave dhe rubeolës, një vajzë 9 vjeçare buzëqesh ndërkohë që i vëllai i saj 16 vjeçar e mban atë mbi kurriz. Aktualisht, familje e saj nomade jeton në provincën e Khövsgöl 'Aimag' verior. Ajo vuan nga një aftësi e kufizuar, që e pengon atë të përdorë këmbët.

Aneksi 1: vazhdim



Nxënës në shkollën fillore Menelik II, në Adis Abeba, Etiopi. Shkolla ka një fokus të veçantë në mbështetjen e fëmijëve më në nevojë, përfshi edhe ata që kanë aftësi të kufizuara, të tilla si dëmtime të shikimit dhe vështirësi të dëgjimit.

Aneksi 1: vazhdim



Një djalë me aftësi të kufizuar fizike është në gjendje të marrë pjesë në një klasë gjithëpërfshirëse në natyrë, Kamboxhia.

Aneksi 2

VEPRIMTARI SIMULUESE QË SUGJEROHEN

Ushtrimet e mëposhtme, që kanë të bëjnë me simulimin, janë përshtatur nga Adcock, B, dhe Remus, M. (2006). *Paketë për rritjen e vetëdijes rreth personave me aftësi të kufizuara*. Mundësitë, Inc.

Për çdo simulim jepen përshkrime të shkurtra të sfidave kryesore që kanë të bëjnë me aftësitë e kufizuara të veçanta. Çdo veprimtari në këtë seksion duhet të mbyllet me një reflektim dhe me ndarje ndjenjash dhe idesh në klasë.

AFTËSIA E KUFIZUAR NË KOMUNIKIM

Çrregullimet e komunikimit janë aftësi të kufizuara që e pengojnë individin të flasë apo të thotë fjalë të kuptueshme.


Shkruani një fjali të thjeshtë në një copë letër, për shembull, “Macja qëndron mbi pullazin e çatisë.” Tregojani këtë fjali një nxënësi. Nxënësi duhet të bëjë që këtë fjali ta kuptojë edhe pjesa tjetër e klasës, pa shkruar, pa folur apo pa përdorur germa të alfabetit.

DËMTIMET E DËGJIMIT

Në dëmtimet e dëgjimit përfshihet gjithçka kur individi nuk është në gjendje të dëgjojë disa tinguj të caktuar e deri te shurdhëria e plotë. Në shumë raste, humbja e dëgjimit nuk nënkupton vetëm faktin që tingujt nuk mund të dëgjoen, zakonisht ajo do të thotë se tingujt janë të shtrembëruar ose të paqartë.

Ju keni nevojë për:

- Një palë tapa veshësh për çdo nxënës
- Një radio, një TV, një ventilator ose gjithçka tjetër që mund të bëjë një “zhurmë të vazhdueshme konstante – të ashtuquajturën “zhurmë të bardhë”



Mësojini nxënësit si t'i vendosin tapat në vesh. Lëshoni “zhurmën e bardhë”. Në rast se përdorni një TV, vendoseni atë në një kanal që nuk ka marrje stacioni dhe ngrini volumin e zërit – aq lart sa ai të jetë shqetësues. Nëse përdorni radion, sintonizoheni atë mes dy stacionesh transmetimi, në mënyrë që të dëgjoni një zhurmë të njëjtë, të deformuar. Nëse përdorni një ventilator, vendoseni atë në shpejtësinë më të lartë. Lexoni shpejt një artikull të gjatë gazete ose ndonjë pasazh libri. Lexoni shpejt, duke përdorur një zë të lehtë, monoton e të mbytur, duke i bashkuar fjalët bashkë e duke u ndalur atje ku nuk duhet. Bëjuni nxënësve 5 pyetje rreth përmbajtjes së asaj që keni lexuar. Filloni të flisni shpejt me një zë të mbytur. Hiqni tapat, largoni zhurmën e bardhë dhe nisni diskutimin (me një zë normal) lidhur me atë se si njeriu ndihet, kur ai nuk është në gjendje të dëgjojë qartë.

Aneksi 2: vazhdim

TË MËSUARIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Ekzistojnë metoda të ndryshme për të kuptuarin e aftësive të kufizuara dhe ato mund të trajtojnë nga problemet më të lehta deri në rastet më të rënda. Një shembull është ai i disleksisë, e cila bën që individit t'i shohë germat të shkëputura dhe sikur ato kanë ndryshuar vendet, sa herë që individit lexon (për shembull "Bule" në vend të "Blue").

Shkruani një numër fjalish të ndryshme, mbrapsht, mbi një copë letër. Duke u dhënë nxënësve shumë pak kohë, kërkojuni atyre t'i lexojnë ato. Ndaleni nxënësin që po lexon, duke i kërkuar atij të nxitojë ose duke i thënë "Kjo është e lehtë për ty."

Për shembull:

"Ajcam e ëzez ëthsë ibm itaç"


"Macja e zezë është mbi çati."

AFTËSIA E KUFIZUAR INTELEKTUALE

Kur një individ ka aftësi të kufizuar intelektuale, kjo do të thotë se ai mëson ose nxë më ngadalë. Nisur nga fakti që këta individë mësojnë më ngadalë, ata nuk mund të mësojnë aq shumë sa mund të bëjnë njerëzit e tjerë. Jo të gjithë ata që kanë aftësi të kufizuar në pikëpamje intelektuale paraqiten njëllor. Një individ mund të ketë probleme më të lehta, të tjerë mund të kenë probleme më të rënda.

Një individ me aftësi të kufizuar intelektuale mund:

- Të ketë vështirësi të kuptojë se çfarë thonë ose nënkuptojnë të tjerët;
- Të ketë vështirësi të shprehë se ç'kërkon të thotë ose se si ndihet; të ketë vështirësi në të kuptuarin e shenjave shoqërore (për shembull, nëse dikush u kthen kurrizin, ai nuk është në gjendje të kuptojë se tjetri nuk do të flasë me ta);
- Të ketë vështirësi të mësojë dhe të përqendrohet;
- T'i duhet të bëjë një gjë shumë herë, më shumë sesa mesatarja e njerëzve të tjerë, përpara se ta përvetësojë atë;
- Të sillet si më i vogël sesa moshën e tij;
- Të mos kuptojë, kur dikush tallet me të;
- Ta ketë vështirësi në shkrim dhe lexim;
- Të mos kuptojë, kur dikush i thotë se po vepron gabim.



Ftoni dy nxënës të ulen ngjitur, me kurriz me njëri tjetrin. Jepini njërit nxënës një letër me një formë abstrakte mbi të:

Aneksi 2: vazhdim

Pa parë njëri tjetrin, ai/ajo duhet t'i shpjegojnë njëri tjetrit se si të vizatojnë këtë figurë abstrakte. Jepini nxënësit të dytë një laps dhe një copë letër. Ai/ajo duhet të vizatojë këtë formë mbi bazën e udhëzimeve të nxënësit të parë.

DËMTIMET PAMORE

Dëmtimet pamore përfshijnë miopinë dhe hipermetropinë, të cilat janë të korrigjueshme me lentet e duhura përkatëse. Këto dëmtime nënkuptojnë gjithashtu verbërinë ose problemet që lidhen me një shikim që nuk mund të korrigjohet me syze.

Ju keni nevojë për:


- Një fashë për lidhjen e syve
- Një dhomë me disa karrige të zëna si edhe me një ose më shumë karrige bosh. Vendosni pengesa gjatë rrugës drejt karrigeve, dhe/ose lëvizni karrigen në një drejtim të papritur. Lini derën gjysmë të hapur.

Shpjegoni se ju duhen dy nxënës – një 'udhërrëfyes' dhe një 'i verbër'. Ri-sistemoni sendet e dhomës. Detyra e udhërrëfyesit është të ndihmojë personin e verbër të hyjë në dhomë dhe të shkojë drejt karriges pa u përplasur me ndonjë gjë tjetër. Nxënësit e tjerë mund t'u thonë atyre se si ta lëvizin dhe gjithashtu si edhe se mund t'i prekin, për t'i orientuar disi në rrugën e tyre. Sigurohuni që fasha e syve të jetë vendosur mirë e të mos lerë kurrfarë mundësia për të parë. Çoni dy vullnetarë të tjerë në korridor dhe ri-sistemoni sërish dhomën. Karrigia bosh nuk mund të gjendet fort lehtë. Të ecësh në një dhomë që nuk di se si janë vendosur sendet, me sytë e mbyllur, pa kurrfarë mundësie për të parë qoftë edhe sado pak, është një përvojë e frikshme. Vulnerabiliteti që lidhet me verbërinë mund të përbëjë një subjekt të mirë për diskutim dhe reflektim në klasë pas kësaj veprimtarie simuluese.

AFTËSITË E KUFIZUARA FIZIKE

Ekziston një shumëllojshmëri aftësish të kufizuara fizike, të cilat variojnë nga problemet e lehta e deri te ato më të rëndat, si, për shembull, pamundësia e plotë për të lëvizur. Shumë njerëz mund të kenë më shumë se sa një aftësi të kufizuar, si për shembull të vuajnë nga pamundësia për të lëvizur këmbët ose duart e tyre.

Nxënësit mund të përpiqen të bëjnë disa veprime të ndryshme duke përdorur vetëm një dorë.

- Të lidhin këpucët e tyre;
 - Të rrinë në radhën e mensës për të marrë ushqimet dhe të hanë drekë;
 - Të hapin një kavanoz, i cili ka një kapak me mbyllje me rrotullim;
 - Të luajnë ketç;
 - Të mbajnë një tufë letrash dhe t'ia zgjasin ato dikujt një nga një; dhe
 - Të shkojnë për të bërë një banjë.
- 



Global Education First Initiative

The UN Secretary-General's Global Initiative on Education

For more information on the #DraëDisability campaign visit:

ëëë.globi-observatory.org/draëdisability

or

ëëë.globaleducationfirst.org

Key Partners:



GLOBAL
OBSERVATORY
FOR INCLUSION



Global Education First Initiative

The UN Secretary-General's Global Initiative on Education

YAG Youth
Advocacy
Group

Technical partners:



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



UNESCO
Associated
Schools



Protecting Children. Providing Solutions.

INEE



GLOBAL CAMPAIGN FOR
EDUCATION
www.campaignforeducation.org

This publication äas made ëith the support of:



علم طفلًا
EDUCATE A CHILD

A programme of education above all™